

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qendrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TË PUNES

Inxhinier Projektues Mekanik

❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Inxhinieri Mekanik është përgjegjës për hartimin e projekteve mekanike (kryesisht HVAC), apo për zbërthimin, ose certifikimin e atyre që bëhen nga të tretë.

❖ DETYRAT KRYESORE

- Planifikim, Projektim, Zbërthim Projekti, Zbatim dhe Supervizim i sistemeve HVAC dhe MKZ
- Hartim i dokumentit ToR (Terma Reference) për fazën e projektimit me specifikimet teknike të impianteve mekanike në teresi;
- Hartimi i projekteve (të gjitha fazat) për instalime termoteknik-ventilimi-kondicionimi, për objekte civile, industriale, turistike.
- Hartim i specifikimeve teknike të detajuara për materialet dhe pajisjet mekanike që do të prokurohen apo tenderohen;
- Hartim i preventivave të punimeve, llogaritje e buxhetit, llogaritje e koheve të punës dhe kapaciteteve të nevojshme për realizim;
- Hartim i listave të detajuara të veglave dhe mjeteve që nevojiten për procesin e instalimit, testimit dhe kolaudit;
- Hartim dokumentacioni (check list) për komisionimin e sistemeve mekanike;
- Ndjekje e procedurave për kontrollin, verifikimin dhe marrjen në dorezim të instalimeve mekanike;
- Hartim i protokolleve të mirëmbajtjes dhe shërbimeve për pajisjet dhe impiantet mekanike në teresi;
- Rishikon & rivlereson projektet nga ana teknike;
- Vendosi standartet e vizatimeve që do të punojë kompania. Kthen vizatimet e pastandartizuara në të standartizuara;
- Ndjek standartet ISO mbi vizatimet dhe vendos rregullat e vizatimeve në kompani;
- Vlereson dhe certifikon kërkesat për ndryshime të ndryshme në projekte.

❖ KRITERET KRYESORE

Edukimi: Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Energjitike

Gjuhë të huaja: Anglisht, Italisht

Njohuri kompjuterike: Msc Office, Autocad, Revit,

Eksperiencë e kërkuar: Min 3 vjetë eksperiencë në projektim.

Te gjithë te interesuarit, janë të lutur që të dergojnë CV nepermjet adreses së e-mailit careers@gener2.al ose të plotesojnë formularin e aplikimit në faqen zyrtare www.gener2.al në seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit është **data 10 Gusht 2026, ora 17:00**.

* Vetëm kandidatet e perzgjedhur do të kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale